



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 125/1 Prot.

Tiranë, më 08.01.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Kërkim-Zbulimit Nr.1920, datë 12.07.2021.

SHOQËRISË “ALRO SUNRISE” SH.P.K

Rr. “Adem Jashari”, Ndërtesa Nr. 1, Hyrja Nr. 2, Ap. 1, Tiranë.

**Për dijëni: SHËRMBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR
Rruga “Zef Serembe”, Tiranë.**

Shoqëria “ALRO SUNRISE” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Kërkim-Zbulimit Nr.1920, datë 12.07.2021, për mineralin krom, në objektin “Lufaj, Selitë”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.

Nga struktura përgjegjëse, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me shkresën Nr.1180, datë 01.11.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.8603 Prot., datë 01.11.2023, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Kërkim-Zbulimit Nr.1920, datë 12.07.2021, për mineralin krom, në objektin “Lufaj, Selitë”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, pasi në objekt nuk zhvillohet aktivitet mineral.

Propozimi është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ë” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet se “Zotëruesi i lejes minerare të kërkim-zbulimit dështon në realizimin e programit minimal të punës.”

Gjithashtu, subjekti “ALRO SUNRISE” me anë të shkresës Nr. 125, datë 08.01.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka kërkuar revokimin e Lejes Minerare të Kërkim-Zbulimit Nr.1920, datë 12.07.2021, për mineralin krom, në objektin “Lufaj, Selitë”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, pasi shoqëria ka hasur problematika me banorët e fshatit përreth dhe nuk është lejuar të ushtrojë të drejtën minerare, e si rrjedhim e ka të pamundur të përmbushi kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në lejen minerare që zotëron.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Kërkim-Zbulimit** Nr.1920, datë 12.07.2021, për mineralin krom, në objektin “Lufaj, Selitë”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, që shoqëria Juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Nr.1920, datë 12.07.2021, për mineralin krom, në objektin “Lufaj, Selitë”, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ENKELEJDA MUÇAJ

